



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Bami” shpk & “BE-IS” shpk

**Adresa: Rruga e Durrësit, Pallati mbrapa “Ring Center”,
Tiranë.**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rruga tek liqeni pranë Ambasadës Hollandeze”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rruga tek liqeni pranë Ambasadës Hollandeze”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-06758-02-06-2019

Fondi limit: 36,642,370 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 11.03.2019, ora 12:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 6 datë 11.02.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk

NUIS K027272020 & NUIS L26310801C

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk

NUIS K02003001O

Vlera e ofertës = 26,136,266.60 (njëzetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS

J68310708M

Vlera e ofertës = 29,210,449.80 (njëzetë e nëntë milion e dyqind e dhjetë mijë e katërqind e dyzetë e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” shpk & “Varaku-E” shpk

NUIS L78223801E & NUIS J61902509S

Vlera e ofertës = 29,291,913 (njëzetë e nëntë milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk

NUIS

J62028009B

Vlera e ofertës = 31,134,521 (tridhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

NUIS

K51712017A

Vlera e ofertës = 32,245,087.30 (tridhjetë e dy milion e dyqind e dyzetë e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bami” shpk & “BE-IS” shpk

NUIS J94416206R & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = 35,136,674 (tridhjetë e pesë milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Geci” shpk

NUIS

K71829801O

Vlera e ofertës = 36,273,273.10 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë dhjetë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS

J67902718S

Vlera e ofertës = **36,466,547.50** (tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dyzetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” shpk & “Meteo” shpk

NUIS K027272020 & NUIS L26310801C

- Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bajrami N.” Shpk & “Meteo” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik Përshkrimin e Ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk
NUIS K020030010**

- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.
- Shoqëria “Eurondërtimi 2000” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamiona përkatësisht me targa AA 488 SB si dhe TR 1598 S. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjeteve të sipërcituara, rezulton se kamionat e sipërcituar kanë kapacitet mbajtës 12.3 Ton dhe 4.4 Ton. Për sa më lart vetëm njëri kamion plotëson tonazhin e kërkuar në DST, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës (10-15 ton)”*.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionçina e si rrjedhojë nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në sistemin elektronik.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcën 10, u konstatua se është paraqitur vetëm me Deklarata Doganore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e

Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.”

- Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinç me targa AA 069 FJ. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjetit të sipërcituar rezulton se nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, gërma “a”.
- Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Elektrosaldatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Elektrosaldatriçe”.
- Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobetoniere përkatësisht me targa DR 8315 E si dhe DR 0134 F. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjeteve të sipërcituara rezulton se për të dyja Autobetonieret e deklaruara nuk janë paraqitur Aktet e Pronësisë dhe Çertifikatat për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, gërma “a”.
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Grejder, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Grejder”.
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Gazogjen, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Gazogjen”.
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe, pasi referuar Shtojcës 10, ka deklaruar 1 (një) Bitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006

“Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk

NUIS

J68310708M

- Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)*” **pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur një deklaratë/dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike.**
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk, referuar mungesës së Shtojcës 10, nuk mund t’i vlerësohen aftësitë e duhura teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” shpk & “Varaku-E” shpk

NUIS L78223801E & NUIS

J61902509S

- Shoqëria “K.M.K” shpk ka paraqitur dokumentin “Vërtetim xhiro” për xhiron mesatare të tre viteve të fundit 2015, 2016, 2017. Xhiro mesatare në vlerën 0 lekë që disponohet nga shoqëria “K.M.K” shpk nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 3, të Nenit 74 të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”. Xhiro mesatare sipas përqindjes së pjesëmarrjes së operatorit ekonomik “K.M.K” shpk (21.38 %) duhet të jetë në vlerën 3,917,069 lekë. Për rrjedhojë nuk plotëson pikën 2, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të DST.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamionçina përkatësisht me targa AA 866 RM si dhe TR 2674 R. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjeteve të sipërcituara, rezulton se kamionçinat e sipërcituara kanë kapacitet mbajtës 5.3 Ton dhe 5.9 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: “*Operatori ekonomik*

duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton”.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” shpk & “Varaku-E” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk

NUIS

J62028009B

- Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionçina përkatësisht me targa TR 3573 I si dhe TR 0098 K. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruar si më lart, rezulton se mjeti me targa TR 3573 I ka kapacitet mbajtës 4.1 Ton, ndërsa kamionçina me targa TR 0098 K ka kapacitet mbajtës 3.4 Ton. Për sa më lart, shoqëria “Hastoçi” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton”.*
- Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe përkatësisht me targa AA 230 UL. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjetit, rezulton se nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Eskavator me goma përkatësisht me targa AEMT 91. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjetit, rezulton se nuk është paraqitur Akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, gërma “a” ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.”*

- Gjithashtu Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinç përkatësisht me targa AA 561 BH. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjetit, rezulton se nuk është paraqitur Akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, gërma “a”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

NUIS

K51712017A

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk është i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamiona përkatësisht me targa AA 585 NE si dhe AA 263 FK. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqëruar për mjetet e deklaruara si më lart, u konstatua se kamioni me targë AA 585 NE ka kapacitet mbajtës 25.1 ton, ndërsa mjeti me targë AA 263 FK ka kapacitet mbajtës 25 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 18, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamion me kapacitet mbajtës 10 – 15 ton”**.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Geci” shpk

NUIS

K71829801O

- Operatori ekonomik “Geci” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë

kohës.....” pasi **drejtuesi teknik i deklaruar rezulton i anagazhuar si drejtues teknik në kontratën e lidhur me bashkinë Tirane me objekt: “Shtim i sipërfaqeve te varrezat Publike Sharrë”**.

- Operatori ekonomik “Geci” shpk nuk plotëson pikën 18 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi **nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet e kërkuara: Autobitumatrice; Autobetoniere, Gazogjen.**
- Operatori ekonomik “Geci” shpk nuk plotëson pikën 18 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*”/ pasi **mjetet: eskavator me targë ABMT07, grejder, rrul me kompresor, rrul me vibrim, kamion me targë AA967RB, kamion me targë AA 965 RB, kamioncina me targa AA 134 PO, AA 032 PS, Autovinc me targë AA 146 PO dhe autobot uji me targë AA 817 RI rezultojnë të angazhuara në kontratën e lidhur me bashkinë Tirane me objekt: “Shtim i sipërfaqeve te varrezat Publike Sharrë”**.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Geci” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

8. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS

J67902718S

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 18 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*”/ **Kamionçinë me kapacitet mbajtës (3.5 -5 ton)**” pasi **asnjë nga kamioncinat e deklaruar në Shtojcën 10 nuk plotëson kapacitetin mbajtës** të kërkuar, konkretisht kamioncina me targë AA 653 HA me kapacitet mbajtës 1,2 ton, kamioncina me targë AA 395 OS me kapacitet mbajtës 0,9 ton , kamioncina me targë AA 179 OL me kapacitet mbajtës 1,3 ton dhe kamioncina me targë AA244UC me kapacitet mbajtës 1 ton. Gjithashtu në shtojcën 10 janë deklaruar edhe kamioncinat me targë AA 918 HP, AA 169 SK **të marra me qera për të cilat nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.**
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 18 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*”/ **Autobitumatrice**” pasi për mjetin e deklaruar në Shtojcën 10 **si Autobitumatrice/ Shpërndarës Bitumi është paraqitur vetëm fatura tatimore, pra pa dokumentacion.** Gjithashtu për Mjetin Autobitumatrice me targë LU 3021 C të deklaruar në Shtojcën 10 si i marrë me qera **nuk është paraqitur**

asnjë dokumentacion.

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 18 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme)”* pasi **nuk është paraqitur Çertifikata për Transport Mallrash të Rrezikshme** për mjetin Autobitumatrice.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Bami” shpk & “BE-IS” shpk**, me adresë: **Rruga e Durrësit, Pallati mbrapa “Ring Center”, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **35,136,674** (tridhjetë e pesë milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 26.03.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.